



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 10010 prot.

Vlorë, më 29.06 2021

URDHËR I BRENDSHËM
NR. 167 DATË 29.06 2021

“PËR AUTORIZIMIN E FIRMËS SË KRYETARIT TË BASHKISË VLORË”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 8 pika 2, neni 9.1 pika 1.1 a dhe b neni 59 pika 3 Neni 64 pika a ,b, Ligji nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 22, për shkak të angazhimit në veprimtarinë jashtë territorit të Bashkisë Vlorë

URDHËROJ:

1. Autorizohet N/Kryetari i Bashkisë Vlorë Z.Shkëlqim Rama që gjatë mungesës së Kryetarit të Bashkisë Vlorë të nënshkruajë si më poshtë:

-Delegimin e shkresave që kanë ardhur /hyrë në Bashkinë Vlorë nga Institucione publike, private apo nga marrëdhëniet me publikun

-Nënshkrimin e shkresave, përmbajtja e të cilave nuk është e lidhur ngushtë me detyrën e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, vërtetime të ndryshme, autorizime, kthim përgjigje.

-Nënshkrimin e shkresave për të cilat autorizohet elektronikisht nga Kryetari i Bashkisë.

2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet N/Kryetari Z.Shkëlqim Rama, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë, për efekt të njoftimit personave të interesuar.

KRYETARI

Dritan Leli